

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**KOMUNËN PASKUQAN TIRANË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Paskuqan Tiranë**, me objekt: *“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 186, datë 29.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 953/6, datë 29.12.2014, i ka rekomanduar z. Fatos Rexha, Kryetar i Komunës Paskuqan, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Është konstatuar se nga komuna Paskuqan nuk janë marrë masa për implementimin e plotë të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*.

**1.1 Rekomandimi:** Komuna Paskuqan të marrë masa për implementimin e plotë të sistemit të Menaxhimit Financiar e Kontrollit, duke ngritur menjëherë strukturat përkatëse dhe të përgatitin dokumentacionin përkatës.

**Deri me datë 31.01.2015**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në dosjet e personelit, për 12 raste janë administruar për secilin punonjës dokumentet shkollore fotokopje të pa noterizuara dhe mungojnë listat e notave, veprime këto në kundërshtim me germen “f”, neni 39 dhe nenet 40, 54, 56 të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 *“Për noterinë”*, i ndryshuar, si dhe me pikat 3, 4, 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, i ndryshuar.

**2.1 Rekomandim:** Komuna Paskuqan të marrë masa dhe të kryejë plotësimin e 12 dosjeve të personelit me dokumentet shkollore (diplomë dhe listë notash), të jenë fotokopje të noterizuara dhe në të gjitha rastet dosjet të plotësohen, sipas kërkesave ligjore.

**Deri më 31.01.2015**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në dokumentacionin që shoqëron transaksionet e kryera në disa raste, urdhërat e shpenzimeve për likujdimin e punimeve të ndërtimit nuk kanë bashkëlidhur; kontratat, preventivat e punimeve, faturat tatimore dhe situacionet e investimeve të kryera, mbi bazën e të cilave dokumentohen punimet e kryera. Dokumentacion ky i përcaktuar në kërkesat e pikës 34, 35, 36 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

**3.1 Rekomandim:** Komuna Paskuqan (Sektori i Financës), për rastet e pagesave dhe transaksioneve që do të kryhen për investime e shërbime në fushën e ndërtimit, urdhër-shpenzimet e likujdimit të punimeve, të shoqërohen me dokumentacionin e nevojshëm, si kontratat, preventivat, faturat tatimore dhe situacionet e investimeve të kryera, etj.

**4. Gjetje nga auditimi:** Në dokumentet e zbatimit të punimeve të ndërtimit, si kontrata, situacione, proces-verbale dorëzimi dhe akte-kolaudimi, nuk janë mbajtur e administruar në dosje të veçanta, ku të jetë e gjithë praktika e zbatimit. Në rastet e përdorimit të fondit rezervë, situacionet e përdorimit nuk ishin bashkëlidhur urdhër-shpenzimeve përkatëse, në kundërshtim me kërkesat e UKM nr. 30, datë 27.12.2011, ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiar”.

**4.1 Rekomandim:** Komuna Paskuqan (Sektori i Financës) të marrë masa, për dokumentet e zbatimit të investimeve, të administrohen në dosje të veçanta e gjithë praktika e zbatimit, sipas regjistrimit kontabël në ditarin e veprimeve të ndryshme dhe në kartelat e AQT-ve. Po kështu të veprohet dhe në rastet e përdorimit të fondit rezervë, ku situacioneve t`u bashkëlidhen urdhër-shpenzimeve përkatëse.

*Në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në disa raste në lidhje me arkëtimet e kryera nga dhënia e dokumenteve administrativo-ligjore banorëve nga Komuna, u konstatua se mungonin bashkëlidhur dokumentimi i shërbimit të kryer nga zyrat përkatëse mungonte dokumentacioni i mbajtur nga zyrat përkatëse si regjistër për vërtetimet e lëshuarar dhe nëfund tëmuajit nuk kishin mbajtur dokument rakordimi ndërmjet zyrave të shërbimit dhe sektorit të financës, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese, ku të jepen në mënyrë analitike të dhënat për veprimet e kryera, numrin dhe llojin e dokumenteve të lëshuara, konkretisht nga zyra së kadastrës, të protokollit, gjendjes civile, etj., në moszbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 34, 35, 36 (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 40-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1 Rekomandim:** Komuna Paskuqan të marrë masa që për arkëtimet e kryera për dhënie të dokumenteve administrativo-ligjore, të kryhen rakordimet periodike deri në mujore ndërmjet sektorit të financës dhe zyrave të shërbimit dhe të administrohen dokumentet e tjera shoqëruese të nevojshme.

*Në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** U konstatua se për rivlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, rezultoi se komisioni i vlerësimit dhe ai i asgjësimit, gjatë punës së tyre nuk kanë mbajtur parasysh kërkesat e Udhëzimit të Ministrise sw Financave nr. 30, datë 27.12.2011, duke mos analizuar dhe dokumentuar faktet, ngjarjet dhe veprimet e ndodhura, mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, etj.

**6.1 Rekomandim:** Nga Komuna Paskuqan (Sektori i Financës) të merren masa lidhur me rivlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata, për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit, në përputhje me pikat 95-110, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

*Në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Lidhur me debitorët, totali i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit paraqitet për shumën 12,003,307 lekë, i trashëguar nga viti 2011, ku sipas partitarit të debitorëve, 939,213 lekë të shumës ishte e

analizuar me 64 poste, detyrime të punonjësve për detyrat e vëna nga KLSH, etj. Përveç këtyre rezultojnë debitorë 6 shoqëri në shumën 5,880,136 lekë, prej vitit 2009, për të cilët nuk rezulton që të jenë ngritur padi civile në gjykatë, për arsye se ka munguar bashkëpunimi dhe rakordimi i veprimeve midis Sektorit të Financës dhe atij Juridik. Pjesa tjetër e detyrimit prej 5,183,958 lekë nuk ishte e analizuar

**8.1 Rekomandim:** Nga Komuna Paskuqan (Sektori i Financës dhe Sektori Juridik) të merren lidhur me debitorët, në shumën 12,003,307 lekë, të trashëguara nga viti 2011 e më parë, dhe të bëhen lajmërimet personave fizikë e juridikë për të likuiduar detyrimet e tyre. Në të kundërtën të ngrihen padi civile dhe të ndiqet procesi në të gjithë shkallët e gjyqësorit, sidomos për detyrimin e 6 shoqërive në shumën 5,880,136 lekë, prej vitit 2009. Të kërkohet në arkiv, të përcaktohet burimi, të analizohet, dhe të vilet nga debitorët, pjesa tjetër e detyrimit prej 5,183,958 lekë.

*Deri më datë 30.06.2015*

**9. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit është konstatuar se planifikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore nuk është shumë i studiuar me argumente bindëse dhe drejtime sipas mundësive reale të njësisë vendore, duke krijuar oshilacione dhe mosrealizime të ndjeshme, nuk është ndjekur si dhe sa duhet arkëtimi i detyrimeve të pa paguara në afat për taksat vendore dhe detyrimet e trashëguara, sipas kërkesave të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, pika 10, “Kontrolli tatimor”, është e analizuar (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 122-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1 Rekomandim:** Komuna Paskuqan dhe Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin e planit vjetor të kontrolleve në drejtimet e përcaktuara.

*Në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Komuna dhe Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjore për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve të Taksës së tokës bujqësore nuk është parashikuar (planifikuar) sipas numrit të familjeve që janë në juridiksionin e Komunës Paskuqan, duke bërë që në buxhetin e sajë të ketë mungesë të pa planifikuara në shumën **598 mijë lekë**, si dhe mos arkëtim të taksës së tokës bujqësore në shumën **1,937 mijë lekë**, të ardhura të munguara në buxhetin e komunës si rezultat i mos zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008” Për Procedurat Tatimore” me ndryshime, Kreu XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara.

**10.1 Rekomandim:** Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e financës dhe Zyrat e tjera të Bashkisë, të marrë masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara dhe te pa planifikuara.

*Në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit është konstatuar se nuk janë planifikuar saktë të ardhurave në vitin **2012** të, të taksës vendore të subjekteve të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, taksës pastrimit, taksës së regjistrimit, mos planifikim të takse popullatës, taksës ndërtesës ( pasurisë ) taksës së pastrimit në vlerën, të pa planifikuara total **16,000 mijë lekë**.

-Mos planifikim të saktë të ardhurave në vitin **2013** të taksës vendore të subjekteve të biznesit të vogël dhe i madh, taksës së pastrimit nga biznesi i vogël

dhe te madh, mos planifikim te taksës popullatës së taksa e pasurisë total **10,488 mijë leke** të pa planifikuar

- mos planifikim të saktë të të ardhurave në vitin **2014** të taksës pastrimit të subjekteve të biznesit të vogël dhe te madh, mos planifikim te taksës pastrimit popullatës, taksa e pasurisë në vlerën në total **26,068 mijë lekë**, si e ardhur e pa planifikuar dhe e munguar.

-mos zbatim të ligjit nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore” neni 12 (Taksa mbi tokën bujqësore) si dhe ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” neni 12 të këtij ligji.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8560 dt. 22.12.1999 “Për procedurat tatimore”, me ndryshimet, me nenin 27, është e analizuar.

**11.1 Rekomandim:** Zyra e Taksave e Tarifave Vendore si dhe zyra e administrimit te tokës bujqësore të ngrenë komision dhe të ndjekin të gjitha procedurat ligjore, në planifikimet vjetore’.

#### *Menjëherë*

**12. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit është konstatuar se nuk janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për subjektet debitorë nga viti 2012 deri në 6 e vitit 2014 për 481 subjekte debitorë në vlerë **8,449 mijë lekë**, në kundërshtim me ligjin me ligjin ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” neni 12 të këtij ligji si dhe udhëzimi nr 24, datë 02.09.200, Kreu i XI “Mbledhja me force e detyrimeve pika 88 dhe pika 89.2, pika 89.3. dhe pika 96, është e analizuar.

**12.1 Rekomandim:** Zyra e Taksave e Tarifave Vendore si dhe zyra e financës dhe zyra juridike e komunës të ndjekin te gjitha procedurat ligjore , deri ne arkëtimin e plotë të detyrimeve të subjekteve debitorë.

#### *Menjëherë*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nuk ka ndarje të detyrave ndërmjet anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreut V, pika 1, germa “a”.

**13.1 Rekomandimi:** Me shkresë të veçantë të bëhet ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, mbi bazën e detyrimeve që përcakton VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të miratohen ato nga titullari i Komunë Paskuqan, me qëllim që të përgjegjësohet secili anëtar i Njesisë së Prokurimit për detyrat që ka dhe të përgjigjet për zbatimin e tyre.

#### *Në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Në disa procedura prokurimi, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është caktuar në urdhrin e prokurimit, kur sipas kërkesave të germës “ç”, pika 2 Kreu V i VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar duhej të ishte ngritur me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor. Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është caktuar z. Skënder Selita, me detyrë inxhinier në Zyrën e Urbanistikës, në kundërshtim me kërkesat e aktit të përmendur më lart, ku përcaktohet se: “ ... Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit.” pasi z. Skënder Selita ka marrë pjesë në hartimin e projektit, preventivit dhe të specifikimeve teknike të tenderit, që janë pjesë të

dokumente të tenderit, si dhe nuk është pjesë e drejtuesve të lartë të Autoritetit Kontraktor.

**14.1 Rekomandimi:**Në drejtimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të caktohen punonjës të nivelit drejtues, si dhe në komision të mos marrin pjesë punonjës që kanë punuar për përgatitjen e dokumenteve të tenderit.

*Në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Në disa raste, dosjet e zbatimit të kontratës për punë publike, ndodhej një procesverbal që i përket kolaudimit të objektit, i cili është nënshkruar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi, kurse në emërtimin e kolaudatorit është shënuar “Komuna Paskuqan”, apo i nënshkruar nga një komision i emërtuar “Për marrjen në dorëzim”. Në këto kushte rezulton të mos jetë caktuar kolaudator i objektit dhe për rrjedhojë nuk është kryer kolaudimi i punimeve. Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 12 të ligjit 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe mban përgjegjësi titullari i autoritetit kontraktor dhe strukturat përkatëse në Komunë, që nuk kanë emëruar kolaudatorët për kolaudimin e punimeve të ndërtimit.

**15.1 Rekomandimi:**Për kolaudimin e objekteve të caktohen kolaudatorë, të cilët të jenë person fizik ose juridik, vendas, ose i huaj, të pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.

*Në vijimësi*

**16. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt “Blerje materiale inerte (çakëll)” në dokumentacionin për zbatimin e kontratës nuk përcaktohet se çfarë sasive materiali (çakëll) është blerë, si dhe nuk i është bashkëlidhur asnjë dokument që të vërtetojë e dokumentojë sasinë e çakllit të blerë. Në këto kushte kur nuk është vërtetuar e dokumentuar sasia e mallit të blerë, nga ana e Zyrës së Financës nuk janë kryer veprimet e hyrjes në magazinë dhe përpilimit të fletë daljeve për dërgimin në destinacion të mallit, si dhe nuk është bërë likuidimi i faturës tatimore nr. 174, datë 8.9.2013 në vlerën 2,064,000 lekë me TVSH, që i përket sasisë prej 2,000 m<sup>3</sup> materia inert (çakëll), të paraqitur nga shitësi.

Fatura tatimore nuk ka nënshkrim konkret të blerësit, por vetëm një shkrim “K Paskuqan” dhe një siglim të pa identifikueshëm për tu përgjegjësuar personi që e ka marrë në ngarkim.

Për sa më lart mbajnë përgjegjësi personat që kanë nënshkruar procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallit pa u shoqëruar me dokumentacionin përkatës, siç e kërkon udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe përgjegjësimin e personave përgjegjës të përdorimit të materialit inert kundrejt dokumentacionit që kërkon ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, udhëzimi nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. Përgjegjësi mban dhe Kryetari i Komunës Paskuqan z. Fatos Rexha që i ka miratuar këto procesverbale.

**16.1 Rekomandimi:**Nga ana e Zyrës së Financës të mos kryhet asnjë pagesë dhe të mos likuidohet fatura tatimore nr. 174, datë 8.9.2013, në vlerën 2,064,000 lekë e përpiluar nga Shoqëria “B..I” sh.p.k. për deri sa nuk është e justifikuar me

dokumentacionin përkatës, në zbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

#### *Menjëherë*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në tenderin me objekt “Evadimi i mbetjeve urbane në Komunën Paskuqan, për vitin 2012”, nëpërmjet situacioneve pjesore nr. 17, datë 30.04.2014 dhe 18, datë 31.05.2014 është likuiduar zëri “Kontenier 3.2 m<sup>3</sup>”, 10 copë me vlerë 1,500,000 lekë, por nga ana e autoriteti kontraktor nuk është mbajtur asnjë dokument apo procesverbale për marrjen në dorëzim të tyre, nuk është ngritur komisioni për pritjen e mallit, siç e kërkon udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” pika 42 e 43 dhe kërkesat e VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b.

**17.1 Rekomandimi:** Nga ana e Zyrës së Financës të bëhet hyrje në magazinë 10 copë kontenierëve me vlerë 1,500,000 lekë dhe të kryhet kontabilizimi tyre shoqëruar me dokumentacionin përkatës, në zbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, 37.

#### *Menjëherë*

**18. Gjetje nga auditimi:** U konstatua se në tenderin me objekt “Evadimi i mbetjeve urbane në Komunën Paskuqan, për vitin 2012”, vendi i grumbullimit dhe ndarjes së mbetjeve urbane nuk është i njëjtë me vendin e përcaktuar në dokumentet teknike të nën kontraktorit “D...-K...” Sh.p.k, por ky proces kryhet fare pranë bregut të Lumit Tiranës në afërsi të Shkollës “Isa Boletini”, dhe më pas mbetjet urbane transportohen në vendgrumbullimin mbetjeve urbane në Sharrë. Vendi i përmendur më sipër është fare pranë qendrave të banuara dhe i pa miratuar në Këshillin e Komunës dhe instancat përkatëse. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 10, pika 3 germa “f”, neni 11, pika “d”, ligjin nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” neni 1, ligjin nr. 10436, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e mbetjeve” neni 5, germa “a” dhe “c” dhe nenin 21 pika 5, VKM nr. 175, datë 19.1.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”, ligjin nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin e mbetjeve të ngurta” i ndryshuar.

**18.1 Rekomandimi:** Nga ana e autoritetit kontraktor, Komuna Paskuqan, duhet të merren masa të menjëhershme ndaj kontraktorit kryesor “I... &SH...” shpk për moszbatimin e detyrimeve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes nr. 1239 prot, datë 28.06.2012.

Bazuar në nenin 10 të kontratës nën/sipërmarrjes datë 11.04.2013 duhet t’i kërkohej kontraktorit kryesor “I... &SH...” shpk që firma e nënkontraktuar “D...-K...” shpk t’i përmbahet detyrimeve të kontratës nën/sipërmarrjes dhe të kryejë grumbullimin provizor dhe ndarjen e mbetjeve urbane në pikën e përcaktuar në dokumentacionin teknik Paskuqan 2, Rruga Doçi, në krahun e majtë të rrugës Institut-Paskuqan, pranë Shkollës “Jashar Hoxha”.

#### *Menjëherë*

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për dokumentacionin e mbajtur për marrjen me qira, nga ana e Komunës Paskuqan, për arsye të funksionimit normal të zyrave për administratën, kopshtit të fëmijëve dhe Sektorin e Ujësjetllës Kanalizimeve, janë marrë me qira 4 (katër) objekte, pronë private, për të cilat janë përpiluar kontrata qiraje, sipas rastit të nënshkruara nga palët.

Në të gjitha rastet, dokumentacioni i paraqitur, si dhe referenca ligjore e përdorur në formulimin ligjor, për kontratat e lidhura, rezultojnë se janë në kundërshtim me ligjin si *baza ligjore* e ndjekur ashtu edhe *dokumentacioni* shoqëruar dhe *mënyra e pagesës* për shërbimin e afuar.

**19.1 Rekomandimi:** Zyra Juridike, në bashkëpunim me Zyrën e Urbanistikës, të bëjnë rivlerësim të çmimit të qerasë, në funksion të sipërfaqeve të mara në përdorim dhe një çmimi të njëjtë për njësinë e sipërfaqeve, të konfirmuara nga urbanistika e sipas gen planeve për çdo objekt.

Për shumatat e llogaritura tepër në pagesa për sipërfaqet tepër, sipas Akt verifikimit nr. 8 datë 25.11.2014, duke marrë në konsideratë observacionet përkatëse, lihet detyrë rillogaritja e vlerës dhe pagesat për sipërfaqet e konfirmuara nga urbanistika, sipas azhurnimit me gen planin e secilit objekt.

*Menjëherë*

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e prognozës së luhatjeve në faturimet, për faktin se në depon me vëllim 1.000 m<sup>3</sup> nga muaji Shtator 2014 e në vazhdim rezultojnë të jetë faturuar aforfe, për arsye të dëmtimit të matësit përkatës, veprim ky në kundërshtim me kontratën dypalëshe, të konkretizuar në nenin 5 pika 2.

**20.1 Rekomandimi:** Për këtë shkelje të kushteve të kontratës sa sipër, nga ana e UKT-së, Sektorit të Ujësjetllës Kanalizimeve në bashkëpunim me Zyrë Juridike në komunë, duhet të kërkojë për çdo rast të faturave të ardhura aforfe, zbatimin e kondicioneve dhe kushteve të kontratës, si dhe zëvendësimin e matësit të dëmtuar, duke kërkuar gjithashtu rishikimin e faturave nga muaji Shtator 2014.

*Në vijimësi*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative", pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimi Ministrisë Financave nr 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap IV, "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve", pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblim e dëmit, në vlerën 2,709,678 lekë si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në tenderin me objekt "Sistemim, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Paskuqan 2 Vreshtë Kufiri Kodër Kamëz", bashkimi i përkohshëm i shoqërive "B.-I." sh.p.k. & "B..." sh.p.k. & "A..K..." sh.p.k., nuk është evidentuar si konkurrent nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe nuk ka asnjë arsyetim për vlerësimin, apo shkualifikimin e tij.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave që nuk ka vlerësuar ofertën e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “BE-IS” sh.p.k. & “B-93” sh.p.k. & “Aurora Konstruksion” sh.p.k., në vlerën 37,298,005 lekë pa TVSH dhe ka shpallur fitues bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë Shoqëritë “Gjoka Konstruksion” sh.a. & “4A-M” sh.p.k., me ofertë 39,501,389 lekë pa TVSH me një diferencë në vlerë prej 2,203,384 lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të përgjigjen anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 101-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Komuna Paskuqan të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën **2,203,384 lekë**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**Brenda datës 31.03.2015**

**2. Gjetje nga auditimi:** U konstatua se në tenderin me objekt “*Evadimi i mbetjeve urbane në Komunën Paskuqan, për vitin 2012*”, nga zëri “*Larje e rrugëve një herë në ditë*”, është përfituar tepër shuma **194,864 lekë** nga nën kontraktori “*D.-K..*” shpk, pasi gjatë të njëjtës periudhë është bërë riparimi i “*Rrugës Demokracia*” në bazë të procedurës së prokurimit të zhvilluar në datë 15.4.2013 dhe nuk ka qenë e mundur realizimi i këtij zëri.

**2.1 Rekomandimi:** Vlera **194,864 lekë**, e likuiduar tepër për zërin “*Larje e rrugëve një herë në ditë*”, duhet të arkëtohet nga nën kontraktori “*D...-K...*” sh p k.

**Brenda datës 31.03.2015**

**3. Gjetje nga auditimi:** U konstatua se në tenderin me objekt “*Evadimi i mbetjeve urbane në Komunën Paskuqan, për vitin 2012*”, zëri nr. 4 “*Mirëmbajtje vendgrumbullimi të mbetjeve gjatë ditës*” është i paargumentuar, gjithashtu ky zë është i përfshirë në zërat e tjerë të punimeve si “*Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve*” dhe “*Grumbullim dhe transporti mbetjeve urbane*”. Nga verifikimi në terren rezultoi se përveç grumbullimit të mbeturinave, nuk bëhej mirëmbajtje e vendgrumbullimeve gjatë ditës, e për rrjedhojë ky zë është preventivuar dhe përfituar padrejtësisht në vlera 129,046 lekë nga operatori “*I..*” sh p k dhe 182,384 lekë nga nën kontraktori “*D...-K...*” shpk. Në total nga të dyja firmat është përfituar padrejtësisht shuma lekë.

**3.1 Rekomandimi:** Vlera **311,430 lekë**, e likuiduar tepër për zërin “*Mirëmbajtje vendgrumbullimi të mbetjeve gjatë ditës*”, duhet të arkëtohet përkatësisht në vlera 129,046 lekë nga operatori “*IRZ*” shpk dhe 182,384 lekë nga nën kontraktori “*Doci-Kijov*” shpk.

Nga ana e Zyrës së Financës të mos kryhet asnjë pagesë tjetër për zërin nr. 4 “*Mirëmbajtje vendgrumbullimi të mbetjeve gjatë ditës*” pasi ky zë është i paargumentuar, gjithashtu është i përfshirë në zërat e tjerë të punimeve si “*Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve*” dhe “*Grumbullim dhe transporti mbetjeve urbane*”.

**Brenda datës 31.03.2015**



## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe në kontratën individuale të punës, t’i kërkojmë Kryetarit Komunës Paskuqan, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

### **C/1. “Vërejtje”, germa ”a”**

**1. A.V.** me detyrë Përgjegjës i Ujësjetllës Kanalizimeve Paskuqan dhe në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

- Nuk është mbajtur asnjë dokument si procesverbal, raport përmbledhës për anulimin e procedurës prokurimit në tenderin “Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2”-“KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik”, nenin 24, pika 3.

- Nuk është hedhur në sistem, si dhe nuk është printuar e bashkëngjitur dosjes tenderit formulari i shkualifikimit të operatorëve, në procedurat e prokurimit “Projektimi Ujësjetllës Babrru”, “Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan” “Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2”, “Riparime, Lyerje, Shërbime në Shkollën 9- vjeçare Tahir Sinani”, “Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2”, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu VI, pika 3, germa “ç”.

- Nuk është publikuar në sistem njoftimi i lidhjes së kontratës si dhe formulari i njoftimit të fituesit, në tenderin “Projektimi Ujësjetllës Babrru”, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu I, pika 3, germa “ç”.

- Përcaktimet e bëra nga Njësia e Prokurimit në dokumentet standarde të tenderit “Projektimi Ujësjetllës Babrru” dhe “Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan” nuk janë të plota, në kundërshtim me kërkesat VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” ndryshuar, Kreu 5, pika 2, germa “a”.

- Nuk është respektuar afati i dorëzimit të dokumenteve për pjesëmarrje në tender në procedurat e prokurimit “Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2” si dhe “KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 43, pika 5.

- Në tenderin Blerje karburanti D1” nuk ka preventiv për përcaktimin e nevojave për karburant për vitin 2013 dhe në tenderin “Blerje materiale inerte” (Çakëll) nuk ka dokument që të tregojë se si është llogaritur çmimi i materialit inert, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreut II, pika 2, germa “c” dhe “ç”.

**2. F.Ç.** me detyrë Përgjegjës i Zyrës Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe anëtar i Komisionit të Vlerësimit Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

- Ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 1, pika 2, germa “d” si dhe nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa “a” dhe “c”, pasi është konstatuar trajtim i pabarabartë i operatorëve

ekonomikë në procedurën e prokurimit “*Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2*”.

- Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Neni 46 “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pasi operatorët e shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim, në 3 raste, në procedurat e prokurimit “*Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2*”, “*Sistemim, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Babru Qendër – Kodër e Kuqe Puseta*”, “*Riparim i rrugës “Demokracia”*”.

- Nuk ka përmbushur kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” neni 12 pika 2, neni 52 pika 3 “*Hapja e ofertave*”, pasi nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është mbajtur procesverbal për hapjen e tenderit dhe për vlerësimin e ofertave në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2013.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Sistemim, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Paskuqan 2 Vreshtë Kufiri Kodër Kamëz*”, si anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk ka evidentuar si konkurrent dhe nuk ka asnjë arsyetim për vlerësimin, apo shkualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “**B.-I.**”sh.p.k & “**B...**”sh.p.k & “**A... Konstruksion**” sh.p.k. Oferta e këtij bashkimi operatorësh ka një diferencë në vlerë prej **2,203,384 lekë** pa TVSH nga oferta e shpallur fituese, e cila përbën dëm ekonomik.

-Për mos mbajtje parasysh të kërkesave të UKM nr. 30, datë 27.12.2011, pikat 95-110, duke mos trajtuar për secilin artikull, se ç`procedurë është ndjekur për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit.

**3. A.H.** me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues si dhe anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

